

## AKTI I THEMELIMIT

### I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar:

**“Voli - H” Sh.p.k.**

#### NENI 1

Ne Sarande sot me daten 02.06.2023 shtetasi i poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

**“Voli - H” Sh.p.k.**

#### NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: **“Voli – H” Sh.p.k.** do te jete ne adresën: Sarande, Lagjja Nr.1, Rruga Butrinti, Godine 1-kateshe me nr pasurie 18/337, Zk.8642.

#### NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: **“Voli - H” Sh.p.k.** do te jete: Bar – restorant, Tregeti me pakice e artikujve ushqimore dhe industriale, Dhenie e automjeteve dhe motocikletave me qera.

#### NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 10,000 leke (dhjete mije) leke, formuar dhe nenshkruar nga 1 ortak ose 1 kuote .

- Ortaku themelues: VOLDET HYSENI: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (dhjete mije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

#### **NENI 7**

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

#### **NENI 8**

Shoqëria cel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaja, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

#### **NENI 9**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1-Asambleja e Ortakëve
- 2-Administratori

Kompetencat e Asamblese së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare “ **Voli - H** ” **Sh.p.k.**

#### **NENI 10**

Administratori i shoqërisë për një afat 5 vjeçar do të jetë:

**Z. VOLDET HYSENI**

#### **NENI 11**

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën kompetentë për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

#### **NENI 12**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, vecanerisht me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” (të ndyshuar).



**NENI 13**

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Themeluesi i shoqerise**

**VOLDET HYSENI**

A handwritten signature in blue ink, consisting of several overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right.